

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE

Korçë, me 16.12.2022

**SHPLLJE VENDIMI**

Drejtuar : Njesise Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Per: shtetasin : Muharem Agolli, me adrese fshati  
Vashtemi, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen per vendimin civil  
nr. 749, dt. 04.11.2022 per t'u afishuar nga ana Juaj  
njoftimi me shpallje me afat 20 ditor, pasi deftesa e  
komunikimit eshte kthyer me shenimin: "Larguar" dhe pas  
afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule  
e firme, ne gjykate.

**KANCELARE**  
**Lubiana KINOLLI**

U afishua sot ne date -----  
Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Nepunesi \_\_\_\_\_  
(emer, mbiemer, firme)

Nr. 143 Prot

Mj. A. G. Libonik  
- 2. Fel. Informacionit ✓  
04.21.12.2022  
C. G. G.



REPUBLIKA E SHqipërisë  
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR  
KORÇE

Nr.regj.them.11112-00240-41-2022 (746)  
Datë regjistrimi 10.02.2022

Nr.vendimi 41-2022-3363 (749)  
Datë vendimi 04.11.2022

VENDIM

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me trup gjykues të përbërë prej:  
Gjyqtarit të vetëm **Seladin PYSQYLI**, asistuar nga sekretare Vitoria Hajçe, në gjykatë,  
sot më datë 04.11.2022, përfundoi gjykimin e çështjes civile me palë dhe objekt:

**PADITËS:** **Vasil (Skënder) Dushku**, i biri i Nefail dhe Zhaneta, i datëlindjs  
28.01.1964, banues në Korçë, përfaqësuar nga Gjinovefa Dushku me prokurë të posacme  
nr.1484 rep. e 566 kol. datë 10.11.2021 të noterisë Korçë (hartuar para noteres Kleva Tabaku),  
me adresë banimi në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

**TË PADITUR:** **1-Edmond Agolli**, i biri i Njaziut, banues në fshatin Vashtëmi, Njësia  
Administrative Libonik, Bashkia Maliq, i papranishëm.

**2-Adem Agolli**, i biri i Dilaver dhe Sabrije, i datëlindjes 15.02.1947, lindur e banues  
në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, prezent.

**3-Muharem Agolli**, i biri i Dilaver dhe Sabrije, lindur e banues në fshatin Vashtëmi,  
Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, i papranishëm.

**4-Fatmir Agolli**, i biri i Dilaver dhe Sabrije, i datëlindjes 11.11.1949, lindur e banues  
në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, prezent.

**5-Qetsor Agolli**, i biri i Njaziut, banues në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative  
Libonik, Bashkia Maliq, i papranishëm.

**6-Ferit Mulla**, i biri i Maliqit, me adresë banimi në fshatin Vashtëmi, Njësia  
Administrative Libonik, Bashkia Maliq, rezultoi se ka vdekur.

**7-Petrit Mulla**, i biri i Njaziut, me adresë banimi në fshatin Vashtëmi, Njësia  
Administrative Libonik, Bashkia Maliq, rezultoi se ka vdekur.

**8-Fillor Agolli**, i biri i Abein, me adresë banimi në fshatin Vashtëmi, Njësia  
Administrative Libonik, Bashkia Maliq, rezultoi se ka vdekur.

**OBJEKTI:** Pjestimin e pasurisë së paluajtshme nr.743/25 e llojit truall dhe ndërtesë  
me sipërfaqe 342 m<sup>2</sup>, e ndodhur në fshatin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik, Bashkia  
Maliq, Zona Kadastrale 3716, regjistruar në volumnin 13, faqe 176.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 369-373 të K.Pr.Civile dhe nenet 199-208 të K.Civil.

Në seancën e sotme, të planifikuar për veprime përgatitore, u paraqit përfaqësuesi i  
paditësit dhe të paditurit Adem Agolli e Fatmir Agolli, ku përfaqësuesi i paditësit deklaroi se  
heq dorë nga gjykimi dhe kërkoi pushimin e gjykimit të çështjes, pasi padinë do ta ngrerë në  
një moment tjetër.

Të paditurit prezent deklaruan se nuk kanë ndonjë kundërshtim dhe janë dakort të  
vendoset pushimi i gjykimit.

Gjykata, pasi dëgjoi palët dhe u njoh me aktet,

### VËREN SE:

Me padinë drejtuar gjykatës, paditësi ka kërkuar sipas objektit të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Gjykata, pasi u njoh me padinë dhe aktet bashkëlidhur, referuar nenit 36/1 të K.Pr.Civile konstatoi se çështja hyn në jurisdiksonin gjyqësor civil dhe bazuar në nenet 41 e 45 të këtij Kodi, kjo gjykatë ka kompetencën lëndore e tokësore për shqyrtimin e saj, si gjykata e vendit ku ndodhet pasuria e paluajtshme objekt konflikti.

Gjatë veprimeve paraprake, bazuar në nenin 158/1 të K.Pr.Civile, gjykata i njoftoi padinë dhe kopjen e akteve provuese të paditurve, si dhe i bëri me dije, që brenda 30 ditëve nga marrja e njoftimit, ka të drejtën të bëjë deklaratën e mbrojtjes dhe të kërkojë marrjen e provave që çmojnë për të kundërshtuar pretendimet e palës paditëse.

Gjykata thirri palët në seancë përgatitore më datë 04.10.2022 dhe urdhëroi njoftimin e palëve. Në këtë seancë u paraqitën përfaqsesit e paditësit dhe të paditurit Adem Agolli e Fatmir Agolli. Pas verifikimit të prezencës së palëve, të paditurit prezent deklaruan se Ferit Mulla, Petrit Mulla e Fillor Agolli, të cilët kanë cilësinë e të paditurvë në padi, kanë vdekur. Nisur nga ky deklaram, gjykata i pyeti ata nëse ishin lëshuar dëshmitë e trashëgimisë por të paditurit deklaruan se nuk kishin dijeni. Përfaqsesit e paditësit kërkuar që ti lihet kohë të bëjnë verifikimin në lidhje me faktin e vdekjes dhe të verifikojnë nëse janë lëshuar ose jo dëshmitë e trashëgimisë, duke kërkuar dhe dhënien e autorizimit për të ndjekur procedurat pranë noterit.

Gjykata pranoi kërkesën e përfaqseses së paditësit dhe i dha autorizimin për të ndjekur procedurat para noterit në lidhje me trashëgiminë e tre të paditurve që rezultoi se kanë vdekur dhe shtyu seancën përgatitore për ditën e sotme datë 04.11.2022, ora 12 :00.

Në seancën e sotme, u paraqit përfaqsesi i palës paditëse dhe të paditurit Adem e Fatmir Agolli, ku përfaqsesi i palës paditëse deklaroi se heq dorë nga gjykimi dhe çështja të pushohet, duke dorëzuar dhe një kërkesë me shkrim, pasi padinë do ta ngrerë në një moment tjetër.

Pasi u njoh me kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, gjykata morri mendimin e të paditurve prezent, të cilët deklaruan se nuk kishin ndonjë pretendim që gjykata të vendosë pushimin e gjykimit.

Nisur nga sa më sipër, referuar nenit 299/ç të K.Pr.Civile, gjykata çmon se duhet të vendoset pushimi i gjykimit, pasi kjo dispozitë parashikon: *"Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ç) Pushimi i gjykimit parashikohet shprehimisht në ligj"*. Në rastin konkret, pushimi i gjykimit për shkak të heqjes dorë nga gjykimi i padisë, parashikohet në nenin 201/1 të K.Pr.Civile, i cili përcakton: *"1. Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelien e çështjes. 2. Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse maspranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshëm"*. Gjykata i morri mendimin palës së paditur, e cila dha pëlqimin për pushimin e gjykimit, por edhe po të mos ishim para kësaj rrethanë, gjykata është para rastit kur mund të vendosë gjykimin edhe n.q.s. të paditurit nuk do të ishin dakort, pasi gjykimi nuk mund të vazhdojë në kushtet kur tre nga të paditurit rezulton se kanë vdekur para ngritjes së padisë.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, paditësi ka parapaguar tarifën mbi aktet dhe shpenzimet e tjera për njoftimet kurse pala e paditur nuk pretendoi për shpenzime të kryera. Në

kushtet kur pushimi vendoset mbi kërkesën e paditësit, shpenzimet duhet të lihen në ngarkim të tij.

M.q.s. gjykata disponon me pushimin e gjykimit të çështjes dhe midis palëve nuk ka detyrim, ky vendim nuk përbën titull ekzekutiv sipas nenëve 510 e 511 të K.Pr.Civile.

**PËR KËTO ARSYE:**

Gjykata, bazuar në nenet 201/1 e 299/c të K.Pr.Civile,

**VENDOSI:**


1-Pushimin e gjykimit të çështjes civile me nr. regj. them.11112-00240-41-2022 (746), datë regjistrimi 10.02.2022, me paditës Vasil (Skënder) Dushku, të paditur Edmond Agolli, etj, me objekt: Pjestimin e pasurisë së paluajtshme nr.743/25 e llojit truall dhe ndërtesë me sipërfaqe 342 m2, e ndodhur në fshtin Vashtëmi, Njësia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, Zona Kadastrale 3716, regjistruar në volumnin 13, faqe 176.

2-Shpenzimet gjyqësore lihen siç janë kryer.

3-Kundër këtij vendimi, paditësi dhe të paditurit Edmond Agolli, Adem Agolli, Muharem Agolli, Fatmir Agolli e Qetsor Agolli, kanë të drejtën e ankimit të veçantë në Gjykatën e Apelit Korçë, brenda 5 ditëve, duke filluar nga e nesërmeja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

-U shpall në Korçë, sot më datë 04.11.2022.

SEKRETARE  
Vitoria HAJÇE



GJYQATAR  
Seladin PYSOYLI

